

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**M&L Auditing Shpk**

Ortaku themelues:

- Znj **Manjola Leka** e bija e Raziut, lindur në Durrës dhe banuese në Tiranë, me numër karte identiteti 035862511.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 20.09.2023 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

**NENI 1**

**Emri**

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin **M&L Auditing Shpk**.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

**NENI 2**

**Forma**

2.1 Shoqëria tregtare **M&L Auditing Shpk**, ka formën e një **shoqërie me përgjegjësi të kufizuar**.

**NENI 3**

**Zyra Qendrore**

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **M&L Auditing Shpk** do të ketë zyrën qendrore të shoqërisë në adresën:

Njësia Bashkiake nr7, Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati E-88, kati 2, Zyra 11, Tiranë.

**NENI 4**

**Objekti i Veprimtarisë**

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj tregtare:

Auditime dhe shërbime të tjera të dhënies së sigurisë, të shërbimeve të lidhura. Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare. Konsulenca ekonomike, financiare dhe fiskale, për njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Përgatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave të drejtuesve të biznesit. Auditime ligjore për lloje të ndryshme të entiteteve të biznesit, tregtare, jo tregtare, përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse. Shërbime të tjera të lidhura me shoqëritë tregtare, si: ndarje, bashkim, përthithje, administrim, kapitali. Auditim të brendshëm për qëllime të biznesit dhe rishikim të kontrollit të brendshëm.

**NENI 5**

## **Kohëzgjatja**

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë **M&L Auditing Shpk** do të jetë me afat të pacaktuar.

## **NENI 6**

### **Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

6.1 Shoqëria tregtare **M&L Auditing shpk** mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

## **NENI 7**

### **Përgjegjësia e Ortakëve**

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë **M&L Auditing Shpk** dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

## **NENI 8**

### **Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **M&L Auditinig Shpk** është 1 000 (një mijë) lekë.

Ortake e shoqërisë është:

1- Znj.**Manjola Leka** është zotëruese e 1 (një) kuote e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

## **NENI 9**

### **Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

## **NENI 10**

### **Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet. Kompetencat e administratorit përcaktohen në statutin e shoqërisë. Administratore e Shoqërisë është znj. Manjola Leka e bija e Raziut, e datëlindjes 03.09.1975, lindur në Durrës dhe banues në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e kartes ë identitetit me numër 035862511.

**Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.**

**Ortake**

**e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

***M&L Auditing Shpk***

**Manjola Leka**

